



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

A.A.nr.10/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar i kolegjit, Erdogan Haxhibeqiri dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen disiplinore ndaj N. K. J. Gjyqtare në Gjykatën Themelore në P., kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë (KGJK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit të KGJK-së, nr.318/2022, të datës 28 korrik 2022, në seancë të kolegjit të mbajtur më datë 22.08.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paraqitur nga N. K. J., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në P., ndërsa vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, KGJK. nr.318/2022, i datës 28 korrik 2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë (KGJK), me vendimin KGJK.nr.318/2022, të datës 28 korrik 2022, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: N. K. J., gjyqtare në Gjykatën Themelore në P., është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafin 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe pikën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që për këtë shkelje disiplinore gjyqtares N. K. J. ti shqiptohet sanksioni disiplinor transferim i përhershëm nga Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në P., në Departamentin e Përgjithshëm të të njëjtës Gjykatë.

Kundër këtij vendimi gjyqtarja në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj dhe për shkak të gabimeve faktike evidente që kanë ndikuar në integritetin e procedurës, me propozim që: Gjykata e Supreme e Kosovës ankesën e subjektit hetimor ta aprovoj si të bazuar dhe ta ndryshoj vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK. nr.318/2022, të datës 28 korrik 2022, duke e liruar atë nga përgjegjësia disiplinore, ose të njëjtin vendim ta anuloj dhe ta kthej në rishqyrtim, ose së paku ta ndryshoj vendimin për sanksionin disiplinor duke i shqiptuar një masë më të butë disiplinore.

Me përgjigje në ankesë, KGJK ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e gjyqtarës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KGJK, më datë 31 janar 2022, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendimin se N. K.J.a – gjyqtare në Gjykatën Themelore në P., mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe pikës 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga KGJK, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor dhe ka propozuar që nëse vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore nga gjyqtarja K. J., t'i shqiptohet njëra nga sanksionet disiplinore të parapara në dispozitën e nenit 7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK-nr.50/2022, të datës 10 shkurt 2022, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/04/2022/GJTHPR-AD/GJTHPR/46/21. Paneli Hetimor më datën 4 maj 2022 i ka paraqitur KGJK-së, raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar dhe marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar të arritur në mes të panelit dhe subjektit të hetimit disiplinor gjyqtarës K. J.

Për ta shqyrtuar marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar KGJK me datë 31 maj 2022 ka mbajtur seancë pa prezencën e palëve. Pasi ka shqyrtuar marrëveshjen KGJK në mënyrë unanime ka vendosur që marrëveshja vullnetare së bashku me sanksionin “vërejtje jopublike me shkrim” të refuzohet, me arsyetim që sanksioni i arritur në mes të panelit dhe subjektit të hetimit është jo proporcional me shkeljen dhe pasojat e shkeljeve disiplinore, shkelje kjo e vërtetuar nga ana e panelit hetimor.

Për ta shqyrtuar raportin hetimor përkatësisht faktet dhe provat e mbledhura nga paneli hetimor, KGJK më datë 07.08.2022 ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë kryesuesi i panelit hetimor dhe subjekti i hetimit disiplinor, në të cilën seancë kryesuesi i panelit ka mbetur pranë marrëveshjes vullnetare të arritur me subjektin e hetimit, me vlerësim se subjekti i hetimit ka pranuar gjendjen faktike për shkeljen e pretenduar nga autoritetit kompetent, përkatësisht mos procedim me kohë të rastit penal në procedurë paraprake PPRKR.nr.741/21 përkundër që ka qenë e njoftuar për rastin nga prokurorja e rastit përmes telefonit dhe postës elektronike.

Sipas të gjeturave të panelit hetimor të bazuara në deklaratën e subjektit të hetimit dhe provave në shkresat e lëndës gjyqtarja N. K. J., me mostrajtimin e rastit penal përkatës, ka shkelur nenin 5, nën-pika 1.3, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përkatësisht ka kryer shkeljen e detyrës zyrtare si gjyqtar. Në këtë seancë subjekti hetimor ka deklaruar se nga prokurorja e rastit kërkesën për arrest shtëpiak e ka pranuar me datë 06.12.2021 e jo me datë 04.12.2021 dhe se nuk e ka pranuar në formë të shkruar por është telefonuar nga prokurorja. Më tej ka deklaruar se mund ta ketë pranuar rastin përmes emailit apo smilit, mirëpo ajo nuk ka pasur qasje në internet ndërsa gjatë vikendeve zyra e referenteve është e mbyllur dhe nuk punon smili.

Më pas KGJK ka vendosur që seancën ta vazhdoj me datë 15 korrik 2022 dhe pasi që ka analizuar çështjen dhe të gjitha provat e bashkëngjitura, ka vendosur që ti drejtohet Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, me kërkesë që të qartësohet baza ligjore dhe praktika që ndiqet nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në rastin kur ka kërkesë nga prokurori për caktimin e paraburgimit dhe të shpjegojë se në çfarë forme pranohen kërkesat në procedurën paraprake gjatë vikendit, cila është përgjegjësia e gjyqtarit dhe referentit përkatës në pranimin e kërkesave dhe rrjedhimisht në çfarë forme zhvillohet komunikimi në mes të gjyqtarit dhe prokurorit të çështjes.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës pas marrjes së përgjigjes nga Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të raportit hetimor, dëgjimit të kryesuesit të panelit dhe subjektit të hetimit si dhe pas vlerësimit të gjitha provave dhe shkresave të lëndës ka nxjerrë vendimin e atakuar KGJK.nr.318/2022, të datës 28 korrik 2022, me të cilin është konstatuar se gjyqtarja N. K. J. është shpallur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i është shqiptuar sanksioni disiplinor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Në arsyetim të vendimit të atakuar, KGJK ka theksuar se: pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit ka konstatuar se gjyqtarja N. K. J. me rastin e mosveprimit të saj brenda afatit ligjor për procedim të lëndës së procedurës paraprake PPRKR.nr.741/21, e që si pasojë e këtij mosveprimi në kohë nga ana e gjyqtarës ka rezultuar që i pandehuri të lirohet në procedurë të rregullt, me ç'rast e njëjta, ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të

Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe pikën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

KGJK ka konstatuar se gjyqtarja N. K. J., është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak të neglizhencës në trajtimin e rastit penal PPRKR.nr.741/21, brenda afateve ligjore dhe se mosveprimi i gjyqtarës për të proceduar dhe organizuar punën rreth kërkesës për sigurimin e të pandehurit në procedurë janë veprime me vetëdije, me ç'rast nënkupton që gjyqtarja ka dështuar ti përmbushë përgjegjësitë Kushtetuese dhe ligjore. Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sjellja e gjyqtarës N. K. J. gjatë procedurës disiplinore para Këshillit ka qenë joserioze, paragjykuese dhe tendencioze, me ç'rast deklaratat e saj dhënë Autoritetit Kompetent te paneli hetimor dhe në seancën dëgjimore nuk kanë qenë koherente, me ç'rast subjekti i hetimit ka cenuar standardet e etikës dhe për sjelljet në procedurë disiplinore, duke tentuar kështu ta pamundësoj qartësimin e plotë të gjendjes faktike lidhur me mosveprimin e saj në procedurë. Më tej KGJK ka theksuar se mënyra e veprimit të gjyqtarës K. J., krijon pasiguri juridike nëse e njëjta do të vazhdoj të ushtroj funksionin në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda, si Departament që trajton çështje serioze në fusha të ndryshme të kriminalitetit dhe neglizhenca e Gjyqtarës përveç që ndikon në imazhin e gjykatës, ndikon drejtpërdrejtë në trajtimin jo të barabartë të rasteve dhe palëve dhe rrjedhimisht shkakton qasje selektive për rastet analoge.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar KGJK ju ka referuar nenit 7 paragrafi 1, pika 1.4, dhe paragrafi 2, pika 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejt dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të subjektit hetimor - gjyqtarit, se vendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i vendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e vendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. KGJK ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për të konstatuar përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarës e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, KGJK në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga

e cila ka rrjedhë përgjegjësia disiplinore e gjyqtares të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i'a ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Gjykata Supreme nuk ka pranuar as pretendimin ankimor për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e KGJK-së, sepse në bazë të provave të administruara KGJK në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se gjyqtarja N. K. J., është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak të neglizhencës në trajtimin e rastit penal PPRKR.nr.741/21 brenda afateve ligjore, dhe mosveprimit të gjyqtares për të proceduar dhe organizuar punën rreth kërkesës për sigurimin e të pandehurit në procedurë, të cilat janë vlerësuar veprime me vetëdije, me ç'rast nënkupton që gjyqtarja ka dështuar ti përmbushë përgjegjësitë Kushtetuese dhe ligjore. Mostrajtimi i rastit dhe mosveprimi me kohë nga ana e gjyqtares, e që ka rezultuar që i pandehuri të lirohet në procedurë të rregullt, lidhur me lëndën me shenjë PPRKR.nr.741/21, sipas vlerësimit edhe të kësaj gjykate paraqet neglizhencë nga ana e gjyqtares.

Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e KGJK-së për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se me nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “*Shkelja e detyrave të gjyqtarit sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë: në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë siç kërkohet me ligj*”. Me nenin 7 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “*Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët; 1.5. propozim për shkarkim*”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “*Masat disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performanca dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore*” Me nenin 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, përcaktohet se: “*Gjyqtari mban nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë profesionale të përgjegjshme dhe efikase*”, me paragrafin 1 të këtij neni, përcaktohet se: “*Funksioni i gjyqtarit ka prioritet kundrejt të gjitha aktiviteteve tjera të gjyqtarit*”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Gjyqtari është i detyruar që të organizoj punën brenda orarit të punës me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës*”, ndërsa me paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet se: “*Gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase dhe të ligjshme*”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe dispozitave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KGJK drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e gjyqtarës të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i'a ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KGJK është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit për faktin se me rastin e vendosjes ka marr parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga gjyqtarja, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilën është kryer shkelja disiplinore, sjellja e përgjithshme e gjyqtarës si dhe sjellja dhe bashkëpunimi i gjyqtarës në procedurë disiplinore, rrethana këto që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e paraqitura, bazuar në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

A.A.nr.10/2022, me datë 22.08.2022

Kryetari i kolegjit  
Zenel Leku